



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, për pozicionin ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 25 qershor. Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot janë 7 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja juaj.

Pa humbur kohë, nëse nuk kemi diskutim mbi përmbajtjen e rendit të ditës, fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin ndihmës ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, projekt-akt i cili do të raportohet nga zonja Luli.

Fatmira Luli: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, z. {...}, me urdhrin nr. {...}, datë 03.06.2015 “Për emërimin e ndihmësve ligjorë” të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është emëruar në detyrën ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mbështetur në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

Me vendim nr. 577, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet ndërprerja e marrëdhënies së punës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe emërimi i përkohshëm në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Verifikimi i pasurisë dhe i figurës, një tjetër kriter që duhet për plotësimin e kushteve për emërimin si ndihmës, konsiderohet i përmbushur, referuar vendimit nr. 751, datë 28.03.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi konfirmimin në detyrë të tij me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Me vendimin e tij nr. 424/2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit të ndihmësve që konfirmohen në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe që kanë të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet profilit aktual për të cilin ai përmbush kriteret.

Këshilli vlerëson se në përputhje me përgjegjësitë që i ka caktuar Kushtetuta dhe ligji për administrimin e pushtetit gjyqësor, është kompetencë e këtij Këshilli, sanksionuar në nenin 59 të ligjit: “1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.”.

Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për ndihmës ligjor, ligji parashikon si të tilla, të njëjtat kriteret të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimit civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kriteret të veçanta për kategorinë e ndihmësit në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji i parashikuar në pikën 2 të nenit 56 të ligjit për pushtetin gjyqësor, të cilat janë: “2.

Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, kandidatët duhet të përmbushin kritere të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare”.

Bazuar në këto kritere, lidhur me plotësimin e kriterëve të pranimit në shërbimit civil gjyqësor të kandidatit z. {...}, evidentojmë faktin se, ka plotësuar kriterin: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; rezulton se ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, 2001-2005; Ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Politike, në Universitetin e Tiranës, në vitet 2005-2010 (Bachelor dhe Master Shkencor); Ka përfunduar Master Shkencor në “E Drejtë publike”, në Universitetin Evropian në vitin 2010.

Gjithashtu, lidhur me kriterin, b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, rezulton se me urdhrin 51, të 2015-ës është emëruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë që nga 2015, duke plotësuar... dhe me vendimin nr. 577, të 2020-ës, për emërimin e tij të përkohshëm, është emëruar ndihmës në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në zbatim të vendimit nr. 424, 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pika 130 “Ndihmësi ligjor që konfirmohet me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tij aktual dhe për të cilin përmbush kriteret” dhe pika 131 “Kërkesa për t’u caktuar në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor paraqitet përpara Këshillit brenda një muaji pas bërjes përfundimtar të vendimit të organeve të rivlerësimit. Në këtë rast marrëdhënia e punës e ndihmësit ligjor në gjykatën përkatëse të apelit mbaron në momentin e marrjes së vendimit për kërkesën e paraqitur nga ai sipas kësaj pike”, Z. {...} ka depozituar, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën për caktim në pozicion në shërbimin civil.

Nga ana e Këshillit konstatohet se zoti {...} ka paraqitur kërkesën e regjistruar me nr. prot. {...}, datë 31.05.2024, në të cilën shprehet interesi për pranim në shërbimin civil gjyqësor, në pozicionin e ndihmësi ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për shkak se ai ka shprehur interesin për emërim Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe pasi ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet për këtë pozicion, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin në këtë pozicion. Ndaj për këtë është e nevojshme verifikimi i organikës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Pas verifikimit, sipas shkresës Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka në përbërje 32 të tillë, nga të cilët në detyrë, në momentin e marrjes së këtij vendimi janë 20 ndihmës ligjor, përfshirë edhe Z. {...}.

Lidhur me emërimin e ndihmësit ligjor, referuar vendimit nr. 424/2020, është parashikuar që për këshilltarë sipas pikës 139 “Në rast se përpara Këshillit, në të njëjtën kohë, janë paraqitur për shqyrtim disa kërkesa në të njëjtin pozicion atëherë ato emërohen sipas renditjes së tyre në testin e aftësive profesionale të Shkollës së Magjistraturës të zhvilluar për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo procedurë e parashikuar nga ligji mban në konsideratë rastin kur kemi më shumë kandidatë sesa vende vakante të lirë, ndërkohë në rastin konkret, kemi vetëm z. {...}, për sa kohë ai ushtron funksionin përkohësisht funksionin në këtë njësi të shërbimit ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm. Procedura e zgjedhjes së tij e parashikuar për renditjen në listë nuk gjen zbatim në rastin konkret.

Si konkluzion, duke konstatuar se zoti {...} plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë “ndihmës ligjor”, në kushtet kur ai është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tij aktual dhe për të cilin përmbush kriteret, si dhe kur aktualisht ushtron funksionin pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm, Këshilli vlerëson ta pranojë në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm.

Për shkak të kushteve dhe nevojave që ka gjykata e apelit, ku kontributi i ndihmësve konsiderohet shumë i rëndësishëm, emërimi i tij duhet të bëhet menjëherë. Për këtë shkak projektvendimi parashikon:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi transferimin e dy automjeteve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit

4. Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi transferimin e dy automjeteve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë për të cilin unë do të ftoja drejtorin e Departamentit të Buxhetit. Në fakt ky projekt-akt është propozim i Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, me anë të së cilit, bazuar në kërkesën që na vjen nga gjykata e posaçme, duke reaguar në mënyrë mjaft të shpejtë mbi nevojat që ka kjo gjykatë për t’u pajisur me makina, ashtu sikurse e ka parashikuar edhe ligji për gjyqtarin e gjykatës së posaçme.

Për më shumë detaje fjalën ia jap drejtorit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijëni, gjatë këtij viti buxhetor, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka miratuar shpërndarje dhe rishpërndarje të disa automjeteve të reja dhe të përdorura, për plotësimin e nevojave të gjykatave të të gjitha nivele.

Por në mbështetje të vendimeve nr. 282, datë 29.05.2024 dhe nr. 283, datë 29.05.2024, me anë të të cilëve Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur caktimin në mënyrë të përhershme të gjyqtarëve z.Ardit Mustafa dhe z.Bib Ndreca, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kjo gjykatë me shkresën nr. 2147, datë 04.06.2024, bazuar në ligjin nr.96/2016, në ligjin nr.98/2016, në ligjin nr. 95/2016, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.777, datë 15.12.2021 “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 478 të Këshillit të Ministrave “Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit” i ndryshuar, me vendimin nr.810, datë 28.12.2023, gjykata me vendimin nr. 286, datë 18.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka paraqitur kërkesën pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për t’u pajisur me dy automjete për gjyqtarët z.Ardit Mustafa dhe z. Bib Ndreca.

Me qëllim mirëorganizimin e veprimtarisë administrative dhe gjyqësore të gjykatës dhe sigurimin e transportimit të gjyqtarëve nëpërmjet marrjes së masave për të garantuar sigurinë fizike të gjyqtarëve nëpërmjet punonjësve të Gardës së Republikës, duke siguruar transportimin e tyre nga banesa në gjykatë dhe anasjelltas, si dhe për të garantuar transportin e tyre në aktivitete të tjera që lidhen me detyrën dhe funksionin, Zëvendëskryetari i gjykatës me urdhrin nr.152, datë 03.05.2024 për shpërndarjen e automjeteve dhe limitin mujor të karburantit që do të përdoren nga automjetet e gjykatës, ka shpërndarë automjetet që ka pasur në dispozicion për të nëntë gjyqtarët që kanë qenë në detyrë, para emërimit të dy gjyqtarëve të rinj.

Kështu, nisur nga nevoja e paraqitur nga gjykata e posaçme e cila është e përligjur dhe emergjente, struktura përgjegjëse për menaxhimin e aktiveve (Drejtoria e Investimeve) në KLGJ, vlerëson kryerjen e transferimit të dy automjeteve tip “Hyunday Elantra” në pronësi të KLGJ-së, edhe për faktin se nga struktura përgjegjëse për prokurimet (Drejtoria e Shërbimeve Administrative) në KLGJ, ka filluar procedurat për

blerjen e dy automjeteve me fondet e kursyera nga realizimi i procedurës së blerjes së automjeteve për sistemin gjyqësor gjatë vitit 2024.

Transferimi i dy automjeteve tip “Hyunday Elantra”, në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor, krahas plotësimit të nevojës së paraqitur nga gjykata, do të lehtësonte dhe realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së automjeteve në këtë gjykatë, pasi e gjithë flota e makinave që disponon kjo gjykatë, janë të të njëjtit tip “Hyunday Elantra” dhe vit prodhimi 2019.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit mbi transferimin e dy automjeteve tip “Hyunday Elantra” 2019, me targa AA 045 ZH dhe AA 483 ZH, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të cilat deri tani kanë qenë në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.
Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord me projektvendimin.

Kam vetëm dy fjalë përgëzuese për Komisionin që e ka sjellë vendimin për transferimin e dy automjeteve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë. Unë vij prej

asaj gjykate, e njoh deri diku problematikën e asaj gjykate dhe jam plotësisht i kënaqur, i bindur që kjo është zgjidhje dhe reagim i shpejt/i mirë dhe dua të evidentoj në këtë rast edhe vëmendjen që ka pasur, ka dhe do të ketë Këshilli i Lartë Gjyqësor për nevojat e gjykatave në përgjithësi si dhe të gjykatës së posaçme, e cila është një gjykatë që është e kategorisë së parë dhe ka problematikat e saj në lidhje me mjetet logjistike që duhet t'i ketë gjithë kohës në dispozicion.

Faleminderit! Jam pro këtij projektvendimi.

Naureda Llagami: Faleminderit z. Kurushi!

Naureda është dakord.

Miratohet projekt-akti i cili është si më poshtë:

1. Miratimin e transferimit të dy automjeteve tip “Hyunday Elantra” viti 2019, me targa AA 045 ZH dhe AA 483 ZH, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri tani në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashië.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Yllka Rupa.

Naureda Llagami: Kalojmë tek vlerësimet.

Fillojmë me vlerësimin e parë që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën 2013 – 2016, shkurtimisht fjalën ia jap znj. Yllka për të bërë relatimin e tij. Nuk ka bërë kundërshtime, të paktën nga informacionet. Nuk ka kërkuar magjistrati që të jetë prezent në seancë. Kështu që zonja Rupa shkurtimisht me konkuzionet.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores, po paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}.

Procedura e vlerësimit të gjyqtarit ka filluar me vendimin nr. 27, datë 24.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe ka kaluar etapat që parashikon ligji dhe aktet plotësuese për vlerësimin e gjyqtarit.

Bazuar në analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit – Njohuritë ligjore.

Lidhur me 1.A.a Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve konkrete. Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët 25.

Lidhur me 1.A.b Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira edhe në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi.

Në lidhje me 1.B. Arsyetimin ligjor, për sa i takon 1.B.a. Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit dhe 1.B.b Strukturës së qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit gjyqësor, propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi, për arsye sepse referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtari paraqet qartësi, koncizitet dhe kuptueshmëri në të gjitha vendimet e arsyetuara dhe vlerësuara dhe gjithashtu ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit gjyqësor.

Për sa i takon 1.B. c Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik, në tërësi, arsyetimi i vendimeve përfundimtare të vazhduara ndjek një zhvillim logjik, duke i kushtuar rëndësinë e duhur parashtrimit të faktit penal, provave dhe analizës së tyre në raport me veprat penale dhe rolin e të pandehurve në kryerjen e tyre, si dhe një analizë e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në çdo rast konkret, në funksion dhe në mbështetje të konkluzioneve të gjykatës. Propozohet nivel vlerësimi shumë i lartë, pikëzimi 25.

Lidhur me nivelin e vlerësimit dhe të pikëzimit për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, lidhur me 2.A. Aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, 2.A.a Sa i takon respektimit të afateve ligjore, referuar të dhënave rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjen e analizuar, për të cilën ligji ka parashikuar afate shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre. Propozohet niveli i pikëzimit 15.

Po ashtu edhe në lidhje me 2.A.b Plotësimin e standardeve minimale kohore, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konstatohet se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuar. Propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje ka rezultuar më e shkurtër se standardi minimal, kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Po ashtu edhe 1.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore, përgjatë periudhës së vlerësimit rezulton në masës 123 %, kështu që propozohet nivel pikëzimi maksimal lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon 2.A.d Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Propozohet niveli i vlerësimit 15.

Për sa i takon 2.B. Aftësisë së gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore, lidhur me 2.B.a Numrin mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive, ka rezultuar që numri mesatar i seancave të jetë 3.6 seanca dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj propozohet vlerësimi me 15 pikë.

Në lidhje me 2.B.b Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar me korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat

proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë po ashtu edhe i pikëzimit.

Në lidhje me 2.C Aftësinë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore, për të dy treguesit “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, propozohet nivel shumë i lartë pikëzimi dhe vlerësimi. Konstatohet se dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi. Nuk konstatohen mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjeve konkrete.

Kështu që lidhur me nivelin e vlerësimit edhe për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit propozohet niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, “Integriteti i gjyqtarit” dhe “Paanësia”, propozohet për të gjithë komponentët të vlerësohet në pikëzimin dhe vlerësimin maksimal për arsye sepse rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Evidentohet se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, në lidhje me “Aftësinë e komunikimit”, referuar të dhënave rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Propozohet niveli shumë i lartë i pikëzimit dhe i vlerësimit gjithashtu.

Respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale të subjekteve të procedimit për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Gjithashtu rezulton që gjyqtari të ketë aftësi për të bashkëpunuar si në aspektin e bashkëpunimit dhe komunikimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, po ashtu ka edhe një shkallë të mirë komunikimi dhe

bashkëpunimi me administratën gjyqësore. Për të dy këto tregues propozohet nivel shumë i lartë vlerësimi dhe pikëzimi.

Lidhur me 4.C Gatishmërisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, provohet pjesëmarrja e tij në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale. Rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në 10 aktivitete trajnuese të zhvilluara gjithsej për 27 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15-120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare të vlerësimit. Propozohet niveli i pikëzimit 20.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve rezulton e provuar, prandaj propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë.

Po ashtu në lidhje me 4.C.c Angazhimin e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, referuar burimeve të vlerësimit, formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit si dhe aktet e paraqitura nga gjyqtari lidhur me këtë tregues, rezulton që brenda periudhës së vlerësimit ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i cili në cilësinë e anëtarit ka marrë pjesë në mbledhje, në grupe pune të mbledhura për administrimin e sistemit të zhvilluara në periudhën e vlerësimit. Gjithashtu, rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar edhe në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë pjesëmarrja në konferenca gjyqësore ndërkombëtare, të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar në projektraportin e vlerësimit.

Në lidhje me 4.C.ç Publikimet ligjore, nuk rezulton të ketë publikime ligjore akademike gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, kështu që nuk vlerësohet lidhur me këtë vlerësues.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 95.

Kështu që në përgjithësi, në mënyrë të përmbledhur niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtarin {...} propozohet të jetë pikëzimi 395, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Naureda Llagami: Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, unë do propozoja që të kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Edhe unë jam dakord me projektvendimin dhe propozimin. Shpreh vetëm vlerësime në lidhje me punën që ka bërë kolegu {...} dhe vlerësimin për periudhën 2013 – 2016 sepse një pjesë e vlerësimit lidhet edhe me ngjarje, situata, vendimmarrje, ku edhe unë kam qenë pjesë e trupës gjyquese që kemi gjykuar bashkë çështje të natyrës shumë të vështirë dhe me thënë të vërtetën gjyqtari i ka përballuar me shumë sukses ato sfida të vështira që ka kaluar në shqyrtimin e proceseve me sensibilitete të larta publike. Kështu që kam vetëm vlerësime dhe jam dakord me propozimet e bëra nga relatori.

Naureda Llagami: Shumë dakord jam edhe unë.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën 2013–2016”, niveli i përgjithshëm "Shkëlqyeshëm".
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Emona Muçi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Priti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Emona Muçi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti i radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zonjës Muçi.

Emona Muçi: Faleminderit!

Procedura e vlerësimit të gjyqtarës {...} ka filluar me vendimin nr. 27, datë 24.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Me këtë vendim, pas shortimit të realizuar janë përzgjedhur vlerësuesit, relatore znj. Emona Muçi, nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Me vendimin e datës 22.04.2024 Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pasi e gjeti të plotë dokumentacionin e dosjes së vlerësimit, vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit dhe njoftimin e projektraportit të vlerësimit me qëllim gradimi për periudhën 2013-2016 të gjyqtarës {...}.

Në lidhje me seancën e sotme gjyqtarja është njoftuar për seancën e datës 25.06.2024, ora 11:00, në lidhje me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të saj.

22

Ka shprehur marrjen dijëni, duke konfirmuar atë dhe ka vendosur dakordësi në lidhje me mospjesëmarrjen në seancë si dhe me mospasjen e ndonjë kundërshtimi në lidhje me këtë vlerësim.

Në lidhje me Njohuritë ligjore, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, pas vlerësimit të burimeve të vlerësimit të administruara në dosje ka rezultuar se në tërësi aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizës e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizimin e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra-tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me 1.A.b Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, nga burimet e vlerësimit në lidhje me këtë komponent, rezulton se në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës

Kushtetuese, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë thelbësor. Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër vlerësoj se duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me 1.B. Arsyetimin ligjor, 1.B.a. Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit. Në konkluzion të burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Në lidhje me shkallën e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimin, referuar sa më sipër, duhet të vlerësohet shumë e lartë duke u pikëzuar me 15 pikë.

Lidhur me 1.B.b Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, nga analiza e burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Në lidhje me këtë komponent, referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Në lidhje me 1.B. c Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, duke u nisur nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon konceptet ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes mbi bazën e një zhvillimi dhe argumenti logjik. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve. Në lidhje me këtë komponent, referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, duhet të vlerësohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, në nivel vlerësimi është "Shkëlqyeshëm", propozohet 100 pikë.

Lidhur me “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën dhe 2.A.a Respektimi i afateve ligjore, nga burimet e vlerësimit rezulton se referuar të dhënave gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjen e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të larta në lidhje me respektimin e tyre. Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej afatit ligjor është 0%.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore - në lidhje me këtë komponent, në konkluzion: për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës logjike të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit:

- (i) raporti i çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar në këtë raport, rezulton në masën 12%;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës por që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, etj.;
- (iii) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit gjatë së cilët gjyqtarja ka përfunduar 1381 çështje, nga të cilat 752 çështje me palë kundërshtarë, duke e tejkalluar standardin minimal sasior “jo më pak se 600 çështje për 3 vjet”, sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së;
- (iv) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është më e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”;

Vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore. Për këtë arsye, referuar sa më sipër vlerësoj se në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se

standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, tejkalohe vetëm për një kategori (civile me palë kundërshtare), si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë. Në lidhje me këtë komponent shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç civile me palë kundërshtare.

1.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore, në lidhje me këtë komponent, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton të jetë në masën 95.4%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”. Në rastin konkret, rezulton se në gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtarja ka gjykuar në total 752 çështje (penale dhe civile me palë kundërshtare), nga 600 çështje themeli që përcakton standardi sasior i punës i llogaritur për periudhën 3-vjeçare. Në këto kushte gjyqtarja për këtë tregues vlerësoj se duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi nga ajo që rezulton nga analiza matematikore, pasi nga kjo e fundit, duket që rendimenti si tregues i aftësive organizative të gjyqtarës, është kushtëzuar nga fluksi i madh i prurjeve të çështjeve të reja, çka nuk është përgjegjësi e gjyqtarës. Propozoj të vlerësohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, në lidhje me burimet e vlerësimit rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar

rezulton më e shkurtër ose e barabartë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, për këtë arsye duhet të pikëzohet me 15 pikë.

2.B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore, 2.B.a Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive, rezulton se në konkluzion, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i ulët se 3 për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë dhe për këtë tregues propozoj 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, në lidhje me këtë komponent, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore dhe për këtë arsye duhet të vlerësohet ky komponent shumë i lartë duke u pikëzuar me 20 pikë.

Në lidhje me 2.C Aftësinë e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore, “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”. Në konkluzion, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues. Duhet të vlerësohet shumë e lartë duke u pikëzuar me 5 pikë.

Në lidhje me “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes”, në konkluzion, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton që gjyqtarja ka shkallë të lartë aftësie edhe për këtë tregues, duke u pikëzuar me 10 pikë.

“Aftësitë organizative të gjyqtarës”, niveli i vlerësimit është "Shkëlqyeshëm" dhe pikët janë 100.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”. Në konkluzion, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se

gjqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi duhet të pikëzohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 35 pikë.

Në lidhje me “Integritetin e gjyqtarës”, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, nga tërësi e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton që gjyqtari gëzon integritet të lartë për këtë arsye për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj dhe duhet të vlerësohet shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

Në lidhje me “Paanësinë e gjyqtarës”, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë nën kriter, konkludohet se: Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me “Përdorimin ose jo të gjuhës diskriminuese”, si konkluzion referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, duke u pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës”, në lidhje me këtë element, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Prandaj, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të vlerësohet si “I pakonsiderueshëm” dhe gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, duhet të vlerësohet në nivel vlerësimi “Shkëlqyeshëm”, me pikët 100.

“Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, në lidhje me “Aftësinë e komunikimit”, “Komunikimi i qartë dhe transparent”, në tërësi, referuar të dhënave që

rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këtë arsye, në lidhje me këtë tregues “Komunikimi i qartë dhe transparent” është shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, në lidhje me këtë komponent, si konkluzion, referuar të gjitha të dhënave, duhet të konsiderohet shumë i lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Në lidhje me “Aftësitë për të bashkëpunuar”, shkalla e bashkëpunimit dhe komunikimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, duke u nisur nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, vlerësoj se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta, duke propozuar si nivel të lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Në lidhje me shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, gjithashtu referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës së dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, vlerësoj se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit. Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi në këtë rast duhet të jetë “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të shkollës së magistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile dhe procedurale civile, gjithsej 9 aktivitete të zhvilluara për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën trevjeçare. Për këto arsye është brenda kufijve ligjore, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Në lidhje me 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve, nga burimet e vlerësimit rezulton që gjyqtarja është angazhuar aktivitete si trajnuese lehtësuese, duke mbajtur në vëmendje se ka qenë lehtësuese në katër aktivitete trajnuese brenda programit

të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe për këtë komponent duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me 4.C.c Angazhimin e gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, rezulton se referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në vitet 2013-2016 në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe aktivitete të tjera. Për këtë arsye gjyqtarja duhet të pikëzohet me tre pikë.

Në lidhje me 4.C.ç Publikimet ligjore akademike, gjithashtu rezulton se referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", në lidhje me pikët, 93.

Vlerësimi i përgjithshëm është "Shkëlqyeshëm". Pikët janë 393.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit?

Atëherë, nëse keni ndonjë diskutim.

Nëse jo, kalojmë në votimin e projektraportit sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...} në periudhën 2013 – 2016. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Ky raporti i miratuar sipas pikës 1 i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 11. Emona Muçi | (anëtare) |

32

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 25.06.2024 (Pika 5)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë tek raporti tjetër që është për ish-kolegen tonë, për zonjën {...} dhe do relatohet nga zonja Irena Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Në mënyrë të përmbledhur do ju parashtroj projektraportin e vlerësimit të gjyqtares {...} për periudhën e gradimit 2013-2016. Procedura për vlerësimin e gjyqtares ka filluar me vendimin nr. 27, datë 24.01.2024, pas dërgimit të akteve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Është përzgjedhur relatorja, ku jam përzgjedhur unë dhe nëpunësja përgjegjëse. Janë kryer të gjitha procedurat për të administruar burimet e së drejtës. Pas plotësimit të akteve është vendosur plotësimi i procedurës dhe më pas është hartuar projektraporti i cili i është njoftuar gjyqtares. Kjo e fundit pasi është njohur nuk ka paraqitur kundërshtime, duke shprehur dakordësinë mbi të.

Në pjesën e parë të projektraportit deri në faqen 32 gjejnë pasqyrim burimet e vlerësimit, me të cilat jeni njohur. Po kaloj direkt tek katër kriteret e vlerësimit. Me kriterin e parë “Aftësia profesionale e gjyqtares”, konkretisht tek treguesi Njohuritë ligjore, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe

33

konfliktin e normave, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në këtë projektraport rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedural lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore. lidhur me zgjidhjen e çështjes. Referuar sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, edhe për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e ligjit të zbatueshëm. Rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së si dhe kujdesi për të zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjes. Referuar sa më sipër edhe për këtë tregues vlerësoj se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së

mendimit juridik. Rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të gjuhës shqipe. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është e pashmangshme. Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi shumë i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine, por gjithmonë kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimin e fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe disa herë të gjata si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik, por kjo nuk krijon paqartësi në vendim.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë. Ka aftësi të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Evidentohet një shkallë e lartë në arsyetimin e ligjit si në aspektin abstrakt, duke e gërshetuar me praktikën unifikuese. Referuar sa më sipër vlerësoj se për këtë tregues aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, edhe në këtë aspekt rezulton se në hartimin e vendimit gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmban në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale, fakteve thelbësore të çështjes, identifikimin e ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes me konkluzionet e arritura të cilat vijnë gjithnjë në përmbyllje procesit të arsyetimit dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin, të cilat janë të plota. Referuar sa më sipër, në tërësi, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B. c Cilësia e analizës dhe argumentit logjik. Edhe lidhur me këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta. Mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Edhe për këtë tregues vlerësohet se aftësia është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për kriterin e parë është pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të "Aftësive organizative", konkretisht për treguesin 2.A. 2.A.a Respektimi i afateve ligjore, nga burimet e vlerësimit, nga 11 çështjet e përzgjedhura me short dhe tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, rezulton se vetëm një çështje i përket kategorisë e cila parashikon afat. Kjo çështje është e natyrës "Vleftësim arresti dhe caktim mase", për të cilën gjyqtarja ka respektuar afatin 48 orë të gjykimit (e ka shqyrtuar brenda 48 orëve). Në tërësi, referuar këtij fakti, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes në zhvillimin e gjykimit brenda afatit ligjor, në çështjet e analizuar në të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira. Për këtë arsye gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit është 0%.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore. Edhe për këtë tregues, duke qenë se nga të dhënat statistikore nuk kemi të dhëna lidhur me plotësimin e standardeve për të gjithë çështjet e gjykuara, do merren vetëm 10 çështjet e përzgjedhura me short dhe tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja, pasi një çështje është me afat ligjor. Konkretisht ka rezultuar se nga 13 çështje standardi minimal është tejkaluar në tre çështje, ku në një çështje standardi minimal është kaluar me një afat tepër të vogël (9 ditësh), tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm. Është bërë një analizë e këtyre tejkallimeve (të afateve standarde) dhe pasi janë zbritur edhe periudha e pushimeve verore, ka rezultuar se gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes në përfundimin e çështjeve brenda standardeve minimale kohore. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe ngarkesën e gjyqtarës, e cila ka

grykuar një numër të lartë të çështjeve (mbi 400 çështje në vit), duke e tejkaluar standardin sasior. Referuar sa më sipër, për këtë tregues, duke iu referuar analizës/të dhënave statistikore, ku ka rezultuar që numri i çështjeve për të cilën ka kaluar standardi minimal është 15%, që sipas metodologjisë vlerësohet me 4 pikë, por duke marrë parasysh shkaqet të cilat kanë çuar në mosrespektimin e këtij standardi, gjyqtarja propozohet të pikëzohet me 5 pikë (duke e rritur me një nivel vlerësimi).

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje. Referuar kategorisë ka rezultuar se për çështjet “Penale krime”, standardi minimal është 2 muaj e 25 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor; për çështjet “Civile themeli” është 3 muaj e 11 ditë, pra brenda afatit 6-mujor për gjykimin e çështjeve civile; është një çështje familjare, rezulton të jetë 6 muaj e 4 ditë. Megjithatë për këtë çështje është bërë analizë dhe ka rezultuar se shkaqet nuk kanë qenë të varura për arsye të gjyqtarës (p.sh. kanë qenë njoftimet me jashtë shtetit); gjithashtu kohëzgjatja për një çështje “kërkesa penale” është më e shkurtër se standardi minimal prej 2 muajve. Sa më sipër, shumica e kategorive të çështjeve janë shqyrtuar brenda standardit minimal, që sipas metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 5 pikë (4 pikë). Por duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjes dhe të zgjatjes së gjykimit civil me natyrë familjare, e cila është një çështje, ndër të tjera, për të cilën është tejkaluar standardi minimal, dhe kjo jo për faj të gjyqtarës, pasur parasysh se gjykimi është shtyrë edhe gjatë muajit gusht kur gjyqtarët dhe administrata kanë kryer lejen e zakonshme; edhe për këtë tregues propozohet pikëzimi me 5 pikë duke e rritur në pikëzimin maksimal.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve. Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit, ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit, ka deklaruar se ka grykuar gjithsej 1386 (janë caktuar) çështje dhe ka përfunduar 1303 çështje, duke mbartur 83 çështje. Rendimenti që është përlllogaritur në raportin e analizimit të aftësive profesionale është 94%.

Referuar të dhënave statistikore, ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit ka grykuar 1205 çështje, nga të cilat 575 çështje janë penale, 484 çështje civile të përgjithshme dhe 146 familjare.

Duke qenë se ne kemi pamundësi për të llogaritur edhe një herë rendimentin nga të dhënat statistikore, rendimenti është marrë i mirëqenë sipas asaj që është llogaritur

tek raporti i analizimit të aftësive profesionale, 94%, e cila sipas metodologjisë së pikëzimit pikëzohet me 8 pikë. Megjithatë, referuar metodologjisë së pikëzimit ku përcaktohet se të dhënat statistikore analizohen me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, duke pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarës, faktin se ajo është caktuar si e deleguar në disa gjykata të tjera, konkretisht në Dibër, Lezhë dhe Krujë, edhe për këtë tregues është propozuar rritja me një nivel, duke e pikëzuar me 10 pikë (nga 8 në 10 pikë).

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit. Nga burimet e vlerësimit, konkretisht për 13 dosjet, të cilat janë burime vlerësimi, ka rezultuar se koha mesatare, për të gjitha çështjet është më e shkurtër se afati procedural ligjor. Koha mesatare për penalet ka rezultuar 3.25 ditë; për kategorinë civile është 3,4 dhe për kategorinë familjare është 2 ditë dhe për kategorinë e kërkesa është 4 ditë, pra gjithmonë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 15 pikë.

2.B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore, 2.B.a Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive. Ka rezultuar se për çështjet e përzgjedhura të administruara me short për të cilën ka të dhëna nga burimet e vlerësimit (çështje me palë kundërshtare) ka rezultuar se numri mesatar i seancave është 2.6 seanca, pra më e vogël se 3 seanca. Nga vëzhgimi i dosjeve të përzgjedhura me short ka rezultuar se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin e plotë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Referuar sa më sipër shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është shumë e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë. Pra edhe për këtë tregues është propozuar pikëzimi i saj maksimal me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Edhe për këtë tregues janë analizuar 11 çështje të përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej të cilave i përkasin kategorive penale, civile me palë kundërshtare dhe një çështje i përket kategorisë së kërkesave penale. Në tërësi ka rezultuar që gjyqtarja kryen veprime të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor,

vlerësohet bazuar ndër të tjera edhe në shkallën e aftësisë dhe efijencës së treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Gjithashtu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat e zhvilluara. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit. Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie për këtë tregues. Aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë kronologjike dhe logjike.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjeve. Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në dosjet gjyqësore ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjyqtarja dhe nuk rezulton asnjë akt që nuk i përket dosjes. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 100 pikë (*lapsus, me 10 pikë.*)

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit për treguesin “Aftësia organizative e gjyqtares”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, edhe për këtë kriter ka rezultuar për të gjithë treguesit e saj ka rezultuar që aftësia e gjyqtares është shumë e lartë, dhe duke e pikëzuar me pikët maksimale me 100 pikë. Konkretisht me pikët maksimale është vlerësuar “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”.

Gjithashtu ka rezultuar “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që mund të ndikojë lidhur me këtë tregues. Për këtë arsye gjyqtarja gëzon integritet të lartë duke e pikëzuar me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtares”, nuk ka rezultuar...

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në komunikim me subjektet e procedimit në përmbajtjen e hartimeve të hartuara. Për këtë arsye rezulton se ka shkallë të lartë lidhur me këtë tregues duke e pikëzuar me 10 pikë (*“Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”*).

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara për përjashtim”. Referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për ekzistencën e numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuara për përjashtimin e gjyqtares. Për këtë arsye ky numër konsiderohet “ i pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Siç e thamë, propozimi për kriterin e tretë është pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, “Komunikimi i qartë dhe transparent”, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve apo edhe në shkresa.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”. Edhe për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë të mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë presumohet që gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Për këtë arsye edhe për këtë tregues vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” si me kolegët ashtu edhe me administratën, ka rezultuar shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar përkatësisht pikëzimi me 15 pikë dhe me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, konkretisht “Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues”. Konkretisht, gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në 12 aktivitete në cilësinë e pjesëmarrëses, gjithsej në 17 ditë trajnim. Sa më sipër vlerësohet se për këtë tregues është brenda kufijve të vendosur 15-120 ditë. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 20 pikë.

Sa i përket treguesit 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr gjyqtarë gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve, nga burimet e vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë në këtë tregues. Për këtë arsye duke qenë se sipas metodologjisë së pikëzimit propozohet pikëzimi me 3 pikë, pasi në rast të vërtetimit të të dhënave do t’i shtohen 2 pikë. Por për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna për këtë tregues, propozohet pikëzimi me 3 pikë.

4.C.c Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale. Edhe lidhur me këtë tregues nuk ka të dhëna që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale. Për këtë arsye, referuar metodologjisë së pikëzimit është propozuar pikëzimi i saj me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore. Edhe për këtë tregues nuk rezulton që gjyqtarja të ketë publikime ligjore. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional” është pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është si më poshtë:

Aftësia profesionale e gjyqtarës, 100 pikë;

Aftësia organizative, 100 pikë;

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë;

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë.

Propozimi i përgjithshëm është si më poshtë, 391 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...} për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 duke e vlerësuar niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Ky raport i miratuar i bashkëngjitet vendimit dhe është pjesë përbërëse.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 7. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |
| 10. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |
| 11. Emona Muçi | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
5. **Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).**
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projektraporti i radhës, që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional për gjyqtaren {...}. Edhe për këtë, relatore është zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Do ju paraqes edhe këtu në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2022. Procedura për vlerësimin e gjyqtares ka filluar me vendimin nr. 179, datë 03.04.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku jam zgjedhur unë si anëtare relatorë dhe Erlanda Agaj si nëpunëse përgjegjëse. Është kryer procedura për hedhjen e shortit, për administrimin e dosjeve burim vlerësimi dhe vendimet e gjyqtares, më pas janë administruar të gjitha aktet të cilat shërbejnë si burim vlerësimi. Pas plotësimit të dosjes, më datë 03.06.2024, nëpunësja përgjegjëse ka depozituar raportin analitik. Më pas me vendimin e datës 04.06.2024 është vendosur plotësimi i procedurës dhe vijimi i punës për hartimin e projektraportit të vlerësimit. Pas hartimit të projektraportit, gjyqtarja është njoftuar rregullisht lidhur me këtë. Kjo e fundit ka deklaruar pasi është njohur se nuk ka kundërshtime dhe është dakord

me përfundimet e arritura në projektraport. Gjithashtu është njoftuar në fakt edhe për seancën e sotme dhe nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim.

Atëherë, po kaloj në mënyrë të përmbledhur, duke qenë se jeni njohur me projektraportin e vlerësimit të gjyqtares. Po kaloj tek treguesit për secilin nga kriteret.

Kriteri i “Aftësive profesionale të gjyqtares”, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, lidhur me përshkrimin e fakteve, lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes, ligjin e zbatueshëm. Po kaloj direkt në konkluzione në rast se nuk keni ndonjë specifike, pasi janë përshkruar në mënyrë të detajuar në projektraport.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mesatare në paraqitjen dhe analizës e fakteve thelbësorë të çështjes të cilat në disa raste paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar me provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre ndërsa në disa raste faktet e çështjes nuk janë përshkruar në pjesën e parë të pjesës arsyetuese-përshkruese, por janë përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike të vendimit. Në pjesën e analizës, gjyqtarja integron provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Ndërsa rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është mbi mesatare, duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Referuar burimeve të vlerësimit (të cilat janë analizuar të gjitha dispozitat të cilat ka analizuar gjyqtarja në vendimet burim vlerësimi në mënyrë të detajuar për secilën prej tyre), referuar të dhënave, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen, interpretim që bëhet si në aspektin abstrakt ashtu edhe në raport me faktet e çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton parimet e së drejtës. Interpretimi i ligjit bëhet në funksion të konkluzioneve për zgjidhjen e çështjes

konkrete. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimeve. Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjyqimit, në aktet procedurale dhe në komunikimin shkresor përgjithësisht është e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces si dhe për lexuesin. Termat teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm...

Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës, i përmend ato në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes.

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe (përveç shkronjës “ç” dhe “ë”, të cilat edhe këto jo gjithmonë i përdor). Në vendimet burim vlerësimi, konstatohet se jo gjithmonë gjyqtarja përdor rregullat gramatikore në drejtshkrimin e saktë të fjalëve dhe në ndërtimin e saktë të fjalive, kryesisht në ndërtimin e fjalive, në mospërdorimin e rregullt të shkronjave të mëdha në fillim të fjalisë, në përdorimin e pasaktë të shenjave të pikësimit dhe fillimit të fjalisë në kryeradhë. Konstatohet se pjesa arsyetuese-përshkuese fillon gjithmonë me shkronjë të vogël dhe kjo karakteristikë e gjyqtarës shikohet në disa raste edhe në vijim të pjesën përshkuese-analizuese.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, ndonjëherë të gjata, duke shprehur mendimin përgjithësisht në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, por që ndonjëherë qartësia dhe rrjedha e mendimit humbet nga fakti i mosndërtimit të saktë të fjalive, përsëritja ose nga mungesa e paragrafëve të mirë dallueshëm. Kjo mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve e vështirëson disi rrjedhshmërinë e vendimit, duke humbur në disa raste filli logjik.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkuese-arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtarja përgjithësisht shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti

të padisë në rastet e pranimit të saj, për faktin se vendimi është i zbatueshëm nga shërbimi përbarimor, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij. Por në lidhje me shpenzimet gjyqësor konstatohet se disponimi i gjykatës jo gjithmonë është i qartë dhe i plotë, pasi në rastin kur gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, nuk ka përcaktuar masën apo raportin e shpenzimeve që i ngarkohen palës konkret ndaj të cilës gjykata ka disponuar. Përcaktimi i saktë i shpenzimeve gjyqësore është pjesë tepër e rëndësishme e vendimit, pasi lidhet me fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe përcaktimi i saktë i shpenzimeve që i ngarkohen njëres palë është detyrë e gjykatës dhe jo e përbaruesit gjyqësor.

Në drejtim të komponentit të “koncizitetit”, konstatohet lehtësisht në mënyrën e të shkruarit të gjyqtarës, zgjatja e mendimit tek pasqyrimi i pretendimeve të palëve, të cilat në disa raste nuk paraqiten në mënyrë të përmbledhur por paraqiten në mënyrë të detajuar. duke referuar kështu si dispozitat ligjore por dhe qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta lidhur me çështjen konkret. Kujdesi që gjyqtarja tregon në pasqyrimin e të gjitha pretendimeve të palëve mbingarkon pjesën përshkruese të vendimit, me përsëritje faktesh si dhe në prova të cilat më pas analizohen tek pjesa e analizës ligjore apo përsëritje të dispozitave ligjore dhe të qëndrimeve të Gjykatës së Lartë. E njëjta karakteristikë e gjyqtarës konstatohet edhe në paraqitjen e qëndrimeve të Gjykatës së Lartë të mbajtur në vendimet unifikuese, ku konstatohet se në vendimin gjyqësor pasqyrohet një pjesë e konsiderueshme e arsytimit të Gjykatës së Lartë (në më shumë se dy faqe) apo rikthim në këto qëndrime, në vijim të analizës së kërkimeve të palëve. Gjyqtari duhet të tregojë kujdes në paraqitjen e përmbledhur të pretendimeve të palëve sepse gjithë përfshirja dhe saktësia e paraqitjes së çdo pretendimi nuk nënkupton ricitim në vendim të gjithë apo një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së pretendimeve të palëve. Gjithashtu, citimi i një pjesë të gjerë të përmbajtjes së vendimeve unifikuese, duke sjellë në disa raste edhe përsëritjen e këtyre qëndrimeve, e mbingarkon së tepërmi vendimin, duke e bërë atë të vështirë të kuptohet nga personat që i drejtohet pasi jo të gjithë kanë njohuri të posaçme për ligjin.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përgjithësisht i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi nuk evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës

përshkruese- arsyetuese, tek nënndarja e pretendimet e palëve apo tek pjesa e analizës ligjore, ku konstatohet se disa pjesë të tij përsëriten fakte, dispozita ligjore si qëndrime të Gjykatës së Lartë. Paraqitja jo gjithmonë e përmbledhur e pretendimeve të palëve, apo tendenca për të pasqyruar një pjesë të konsiderueshme të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, duke sjellë edhe përsëritje të herë pas herëshme të tyre, nuk e bën të qartë vendimin për një person të zakonshëm (jo jurist). Në mungesën e koncizitetit ndikon edhe mospërdorimi i saktë i rregullave gramatikore.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e saj për këtë tregues është mesatare, duke e pikëzuar me 9 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar të vendimit. Nga burimet e vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet kryesisht me përshkrimin e pretendimeve të palëve, në disa raste me prezantimin e disa fakteve në lidhje me themelin e çështjes (jo atyre me natyrë procedurale), identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Megjithëse konstatohet se gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të pjesëve përbërëse të vendimit edhe pse jo në aspektin formal të saj, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim. Në disa vendime burim vlerësimi mungon pasqyrimi i rrethanave të faktit (sikurse jemi shprehur në treguesin i parë) siç kanë rezultuar gjatë gjykimit, të cilat më pas përshkruhen dhe analizohen tek pjesa e analizës apo argumentit logjik mbi faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve, duke filluar arsyetimin direkt me pasqyrimin e pretendimeve të palëve, apo dhe me citimin e provave të paraqitura prej palës paditëse, për të vijuar me arsyetimin mbi bazueshmërinë e këtyre pretendimeve në prova ligjore.

Vendimi është i ndarë në tre... ka pjesën hyrëse, e cila është e plotë; pjesa përshkruese e vendimit e cila organizohet në një strukturë të qëndrueshme dhe unike, por jo gjithmonë e ndarë në paragrafë sipas një rrjedhe logjike apo e ndarë në pjesë apo nënpjesë me tituj apo me fjali hyrëse përshkruese. Mënyra e organizimit të pjesës përshkruese ndjek përgjithësisht këtë renditje: prezantimi i fakteve të çështjes, rrethanave të faktit, pretendimet e palëve (pasi siç e kam konstatuar në disa raste mungon pasqyrimi

i fakteve siç kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor, por pasqyrohen vetëm sipas pretendimeve të palëve), vlerësimi i gjykatës.

Edhe për këtë tregues, në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: parashtrimi i rrethanave të faktit (në disa raste dhe jo gjithmonë paraqitet i plotë), pretendimet e palëve, analizimin e fakteve dhe të provave të paraqitura, duke e integruar me ligjin e zbatueshëm që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata, ndërsa në disa vendime strukturimi nuk bëhet sipas këtij rendi logjik. Përgjithësisht konstatohet se gjyqtarja strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik. në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi në përshkrimin dhe analizën e fakteve procedurale dhe në paraqitjen e ecurisë procedurale të çështjes, e cila në disa raste është e nevojshme dhe as në përshkrimin dhe analizën e fakteve thelbësore të çështjes.

Referuar sa më sipër vlerësohet se aftësia e saj është mbi mesatare, duke e pikëzuar me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentit logjik. Nga burimet e vlerësimit rezulton, duke e marrë si një e tërë, pa i dhënë peshë secilës, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Argumentimi për çdo konkluzion të arritur mbi çështjet e analizuara, si në aspektin procedural ashtu edhe në lidhje me themelin ka në bazë një analizë të detajuar dhe të integruar të provave, interpretim të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimin mbi faktin konkret, duke evidentuar qartë marrëdhënien shkak-pasojë dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e parë është 87 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

“Aftësia organizative e gjyqtarës”, konkretisht 2.A.a Respektimi i afateve ligjore. Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 104 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 97 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 7 çështje janë shqyrtuar brenda afatit. Sa më sipër, pasur parasysh numrin e çështjeve të shqyrtuara tej afatit rezulton se gjyqtarja të ketë gjykuar 93.2% të çështjeve jashtë afatit ligjor. Megjithatë, pasur parasysh pretendimet e gjyqtarës mbi shkaqet të cilat kanë çuar në mosrespektimin e afateve të gjykimit, të cilat janë pasqyruar edhe në raportin e vlerësimit, është bërë edhe një rillogaritje e të dhënave duke zbritur kohën e lejes vjetore, festat e fundvitit, raportet e paaftësisë së përkohshme në punë të cilat ndodhen në dosjen e vlerësimit, dhe ka rezultuar pas një rillogaritjeje, janë zbritur 5 çështje të cilat mund të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit. Megjithatë edhe nga kjo rillogaritje rezulton se përqindja është përsëri tejet e lartë, duke qenë në 88.46 %, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 3 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të caktuar një shkallë më të lartë pikëzimi deri në pikëzimin maksimal. Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka gjykuar 1097 çështje nga të cilat 104 çështje parashikojnë afat ligjor. Rezulton se nga numri i çështjeve të përgjithshme 194 çështje janë me palë kundërshtare dhe 903 çështje pa palë kundërshtare, nga të cilat 772 janë urdhra ekzekutimi, 62 kërkesa për regjistrim dhe depozitim OJF apo parti politike.

Lidhur me aspektin sasior rezulton se gjyqtarja ka qenë në seksionin civil të përgjithshëm dhe duhet të gjykonte minimalisht 120 çështje. Ka rezultuar se gjyqtarja e ka tejkaluar këtë standard sasior me 61 % për çështjet me palë kundërshtare, ndërsa për çështjet me palë kundërshtare që sipas vendimit të ish-KLD-së duhet të shqyrtonte 400, e ka tejkaluar duke gjykuar 903 çështje pa palë kundërshtare, me 125.7%.

Në lidhje me rritjen e volumit të punës si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit 2022, gjyqtarës i janë caktuar me short 1014 çështje, nga të cilat 316 janë çështje me palë kundërshtare dhe 693 kërkesa (në raport është 698). Gjatë vitit 2022 gjyqtarja ka qenë e angazhuar me procesin e

vlerësimin kalimtar deri në datën 10.06.2022 (datë kur është dhënë edhe vendimi i KPK-së).

Referuar sa më sipër, pasur parasysh të gjitha këto të dhëna, konkretisht ngarkesën si relatore gjatë periudhës 2022, numrin e lartë të çështjeve të caktuara në vitin 2022 të cilat u cituan më sipër, vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve, numrin e çështjeve me afat ligjor, pasi rezulton se ka përfunduar 104 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 9.5 % të çështjeve të përfunduara prej saj në vitin 2022, numër i cili është relativisht i ulët në raport me numrin tjetër të çështjeve; sa më sipër referuar analizës logjike të të dhënave, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel të ndryshëm pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore, duke e pikëzuar 12 pikë, por kurrësi nuk mund të shkojë në një pikëzim maksimal, pasi përqindja e lartë e çështjeve të shqyrtuara jashtë këtij afati nuk mund të justifikojë një pikëzim të tillë. Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 12 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore. Edhe për këtë tregues, ka rezultuar se nga 993 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerëimit për të cilat zbatohet standardi sasior, 814 prej tyre ose 81 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor. Edhe lidhur me këtë tregues është bërë edhe një rillogaritje e të dhënave të pasqyruara sipas të dhënave statistikore, ku pas një rillogaritje janë zbritur gjithsej 36 çështje të cilat do të vlerësohen se janë gjykuar brenda standardit minimal, duke u zbritur kështu çështjet nga 814, në 778 çështje, përqindje e cila shkon në 78.3%, që sipas metodologjisë së pikëzimit pikëzohet përsëri me 1 pikë pasi është mbi 40%.

Referuar metodologjisë së pikëzimit edhe për këtë tregues të dhënat statistikore analizohen me qëllim për të shmangur përfundime të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Edhe për këtë tregues është vlerësuar ngarkesa e gjyqtarës, numri i lartë i çështjeve të cilat gjyqtarja ka gjykuar gjatë periudhës së vlerëimit.

Për sa më sipër për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave statistikore, numrin e ulët të gjyqtarëve detyrë, të cilët janë mbingarkuar edhe me rishortimin e çështjeve të lëna nga gjyqtarët e shkarkuar, ngarkesën e gjyqtarës si relatorë (në total 1097 çështje), faktin se ajo e ka tejkaluar standardin sasior në masën 61.6% për çështjet me palë kundërshtare dhe me 125.7% me çështjet pa palë

kundërshtare; faktin se gjatë periudhës 1-vjeçare i janë caktuar 1014 çështje në gjykim, nga të cilat 316 janë me palë kundërshtare; faktin që përgjatë vitit 2022 gjyqtarja ka qenë në proces rivlerësimi dhe shpjegimet e gjyqtares, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në një nivel të ndryshëm nga ai që i përkon të dhënave statistikore duke arritur deri në nivelin maksimal me 5 pikë. Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje. Përgjithësisht ka rezultuar më e gjatë për të gjitha kategoritë e çështjeve përveç kategorisë “tregtare me palë kundërshtare”, ku ka rezultuar më e shkurtër se afati prej 2-mujor. Për këtë arsye duke qenë se shumica e kategorive është më e gjatë se afati standardi minimal, sipas metodologjisë së pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me pikëzimin 2 pikë. Megjithatë edhe për këtë tregues, në metodologjinë e pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares. Edhe për këtë tregues analiza është bërë si për treguesin e mëparshëm të respektimit të standardeve minimale. Megjithatë, duke mbajtur parasysh të gjitha këto të dhëna, vlerësoj se niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korrespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelë, duke e pikëzuar me 4 pikë. Për këtë tregues gjyqtarja është propozuar pikëzimi me 4 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve. Referuar të dhënave statistikore rezulton se rendimenti është 108 %, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 10 pikë. Sa më sipër për këtë tregues është propozuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit. Përgjithësisht ka rezultuar në disa raste më e shkurtër dhe në disa raste më e gjatë se afatet ligjore. Konkretisht për çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare ka rezultuar 20 ditë, aq sa parashikon neni 308; për çështjet civile të përgjithshme pa palë kundërshtare është më e gjatë, është 27 ditë; për tregtare me palë kundërshtare është më e gjatë; për kategorinë tregtare pa palë kundërshtare është më e shkurtër; dhe marrëdhënie pune është me gjatë. Pra ka rezultuar tre nga pesë kategoritë, nuk është respektuar afati ligjor. Gjithashtu rezulton se dy nga tre kategoritë, afati është tejkaluar me 1-2 dytë nga afati i përgjithshëm prej 20 ditë, tejkallim i cili vlerësohet se është i papërfillshëm, ndërsa në kategorinë e tretë ky afat është tejkaluar me 7 ditë. Pra, nëse do t’i konsiderojmë si të papërfillshme tejkallimet me 1-2

ditore, koha mesatare e arsyetimit rezulton të jetë më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive, pra për 4 nga 5 kategoritë, që sipas metodologjisë së pikëzimit llogaritet me 12 pikë.

Duke pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit, ku ka rezultuar se ka dhënë 1093 vendime, nga të cilat 194 janë çështje me palë kundërshtare dhe 899 janë kërkesa civile, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, është propozuar rritje e pikëzimit me një nivel, duke e rritur me 15 pikë.

2.B. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore, 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme. Për këtë kategori, ka rezultuar, referuar burimeve të vlerësimit, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave për të gjitha çështjet, janë analizuar vetëm çështjet e përzgjedhura me short (5 dosjet e përzgjedhura me short). Referuar Raportit Analitik, rezulton se 5 dosjet e përzgjedhura me short, rezulton se janë zhvilluar 60 seanca gjithsej, nga të cilat 30 seanca përgatitore dhe 30 gjyqësore, ku këto të fundit janë zhvilluar në vetëm 4 dosje, pasi për një çështje është vendosur shpallja e mos kompetencës në seancë përgatitore. Pra për katër çështje janë zhvilluar 30 seanca gjyqësore nga ku ka rezultuar se numri mesatar është 7.5.

Nga vëzhgimi i dosjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja përgjithësisht ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve të palëve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: shtyrë për arsye shëndetësore të gjyqtarës; ka qenë me leje vjetore; për njoftimin e palëve që nuk kanë dijeni; për njoftimin e personit të tretë, për njoftimin e avokatit të palës së paditur, për shkak të tejkalimit ose orës së vonë të seancave, planifikimi, për paraqitjen e provës nga pala e paditur; për listimin e provave, për t'i dhënë kohë palëve për përgatitjen e pretendimeve përfundimtare.

Pra, në tërësi, shtyrjet kryesisht kanë qenë për shkaqe objektive, shumicën e raste të pavarura nga veprimet e gjyqtarës si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor procedural.

Megjithatë konstatohet se jo gjithmonë gjyqtarja ka marrë masa për zhvillimin e një gjykimi të pandërprerë, ashtu siç parashikon Kodi i Procedurës Civile, sidomos me ndryshimet që ky kod ka pësuar me ligjin nr. 38/2017, i cili e ka normuar veprimet që kryhen nga gjyqtari pa caktuar seancë, ato që kryhen në seancë përgatitore, si dhe veprimet që kryhen në seancë gjyqësore, ku paraprakisht janë përcaktuar provat që do të merren në shqyrtimin, duke e kufizuar mundësinë e marrjes së provave të reja në seancë gjyqësore, të cilat nuk janë paraqitur që në veprimet paraprake, apo së bashku me deklaratën e mbrojtjes. Kodi i Procedurës në nenin 186 ka parashikuar rastet se kur mund të merren prova të reja. Kryerja e të gjitha këtyre veprimeve të nevojshme të parashikuar në ligj, kanë synuar pikërisht zhvillimin e një gjykimi të pandërprerë, duke përfunduar në një seancë gjyqësore, apo në një numër të vogël seancash gjyqësor. siç mund të jetë shtyrja për të paraqitur pretendimet e fundit me shkrim. apo shtyrja për shpalljen e vendimit.

Konkretisht konstatohet se në dy çështje gjyqtarja ka ndërprerë seancën gjyqësore, me arsyetimin e tejkalimit të afatit të caktuar, megjithëse nuk ka përfunduar orari zyrtar (një ka qenë në orën 12:00 dhe një në orën 15:30) dhe në një rast është shtyrë për listimin e provave. Gjithashtu, konstatohet se në dy dosje gjyqësore, gjyqtarja ka shtyrë seancën me qëllim paraqitjen e provave të reja nga palët në proces, të cilat nuk janë paraqitur që në veprimet paraprake, apo në seancë përgatitore, pa u marrë vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke mos arsyetuar mbi shkaqet që kanë çuar në mosmarrjen e këtyre provave më parë, sipas nenit 186 të K.Pr.Civil, çka tregon një administrim jo shumë efikas, me qëllim vijimin e një gjykimi të pandërprerë.

Referuar sa më sipër, pasur parasysh numrin tejet të lartë të numrit të seancave, e cila është 7.5, rezulton se numri është 7.5 dhe përgjithësisht gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel mesatar, duke e pikëzuar me 9 pikë.

Pra për këtë tregues është propozuar pikëzimi i saj me 9 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Për këtë tregues, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie për këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në

shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil: që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore kur është e nevojshme, dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale apo me ndjekjen e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor.

Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

Sa i përket treguesit 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit. Në tërësi rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të kuptueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal dhe aktet janë numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Për sa më sipër është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit. Edhe për këtë tregues ka rezultuar aftësia e gjyqtarës shumë e lartë, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes apo mungesa e akteve që lidhen me çështjen.

Referuar sa më sipër, propozohet pikëzimi me 10 pikë.

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative e gjyqtarës”, është pikët 90, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi profesional”, për këtë kriter, për të gjithë treguesit e saj, aftësia e gjyqtarës ka rezultuar shumë e lartë dhe është propozuar pikëzimi me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Po e kaloj sepse ka rezultuar për të gjithë treguesit aftësia e saj shumë e lartë.

Sa i përket kriterit të katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht “Komunikimi i qartë dhe transparent”, rezulton se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, aftësia është shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët ashtu edhe me administratën”, ka rezultuar shumë e lartë, duke e pikëzuar përkatësisht me 15 pikë dhe me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, konkretisht “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës”. Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja ka marrë pjesë në programin e trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses konkretisht në 4 aktivitete trajnuese, zhvilluar gjithsej në 4 ditë trajnimi, duke mos plotësuar afatin minimal që parashikon ligji prej 5 ditëve (ligji dhe rregullorja). Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 4 pikë. Në fakt gjyqtarja për këtë tregues në raportin e rivlerësimit ka paraqitur një vërtetim të paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës, duke thënë se gjatë periudhës së vlerësimit, njëra nga trajnimet e planifikuara nga ana e gjyqtares ka qenë me dy ditë, por është zhvilluar me një ditë. Megjithatë, pasur parasysh faktin se gjyqtarja ka marrë pjesë në katër aktivitete dhe nuk rezulton koha kur është anuluar kjo e dhënë, është propozuar pikëzimi me 4 pikë, pasi është jashtë kufijve 5-30 ditë parashikuar në ligj.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton se gjyqtarja të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues. Ndërsa referuar dosjes së saj personale si dhe informacionit të paraqitur së bashku me formularin e vetëvlerësimit, rezulton se (në fakt janë verifikuar edhe vendimet e KLGJ-së nga ana ime si relatore), ku ka rezultuar se gjyqtarja është caktuar edhe si mentore gjatë periudhës së vlerësimit dhe janë përcaktuar edhe emrat e kandidatëve për gjyqtarë, për të cilët ajo ka bërë mentorim. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 5 pikë për këtë tregues.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstytucionale. Nuk rezulton, lidhur me këtë tregues, që gjyqtarja të jetë e angazhuar në veprimtari ndërinstytucionale. Për këtë arsye, është propozuar pikëzimi i saj me 3 pikë.

Gjithashtu nuk rezulton që të ketë publikimet ligjore. Për këtë arsye është propozuar me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e katërt është pikët 77, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Atëherë, propozimi për nivelin e vlerësimit është si më poshtë, për të gjitha kriteret:

Aftësia profesionale e gjyqtarës, 87 pikë, niveli "Shumë mirë";

Aftësia organizative, 90 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Aftësia personale dhe angazhimi profesional, është 77 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm është 354 pikë. Niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Gjithashtu, bashkë me projektraportin, janë bërë edhe disa propozime dhe rekomandime, ku është rekomanduar që gjyqtarja t'i kushtojë më shumë rëndësi pjesës së pasqyrimin të fakteve të çështjes, qartësisë së vendimit si dhe strukturës së vendimit. Gjithashtu, të mbajë në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstytucionale, në programin e trajtimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si pjesëmarrëse, lehtësuese apo eksperte, si dhe publikimet ligjore. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Fatmira Luli: Po, kisha unë.

Naureda Llagami: Po!

Fatmira Luli: Gjyqtarja {...} është një nga gjyqtaret e vjetra dhe më me eksperiencë dhe me shumë integritet, e Gjykatës së Tiranës, dhe mendoj që ky lloj vlerësimi nuk i përgjigjet aftësisë, cilësisë, integritetit të saj, sidomos në lidhje me arsyetimin e vendimit dhe me pikat e para të vlerësimit. Ajo s'ka bërë vërtetë asnjë kundërshtim, por nga raporti lexoj që për të tëra këto çështje ka paraqitur një vlerësim

57

më të lartë për veten e saj, jo në nivelin mesatar. Konkretisht, gjykoj që “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave” është vlerësuar me 20 pikë, nga 25 pikë që është shumë e lartë. Po të shohësh raportin që është përgatitur nga relatorja, thuhet që: Gjyqtarja ka vlerësuar aftësinë e saj për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave shumë të lartë, duke u shprehur se: “Në lidhje me aftësinë time për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm e vlerësoj shumë lart”.

Konkluzioni i relatores është: “Rezulton se gjyqtarja ka aftësi mesatare në paraqitjen e analizës së fakteve thelbësore të çështjes në të cilat në disa raste paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre, ndërsa në disa raste faktet e çështjes nuk janë përshkruar në pjesën e parë të pjesës arsyetuese-përshkruese, por janë përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike të vendimit. Në pjesën e analizës, gjyqtarja integron provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Ndërsa rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.”.

Mbas këtij konkluzioni propozohet që niveli, duke identifikuar shkallën e aftësisë së gjyqtares, pas analizës së të dhënave (citon): “Vlerësoj se aftësia në lidhje me treguesin "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave" është “Mbi mesatare”...”.

Gjykoj që për këtë duhet të jepet maksimumi 25 pikë shumë e lartë, për shkak se, të tëra parashtrimet këtu nuk më bindin që vërtetojnë që kjo aftësi është mesatare, por është e kundërta. Nuk kemi një shabllon ne për vendimet se kur paraqitet arsyetimi. Thuhet në pjesën arsyetuese paraqiten fakte, por kjo s’e pengon njeri që të evidentojë elementë të tjerë në pjesën analizuuese për provat edhe faktet; dhe nuk shoh evidentimin e ndonjë mangësie në të cilën mund të thuhet që nuk ka parashtrim faktesh, nuk ka arsyetim ose gjëra që e bëjnë vendimin të pakuptueshëm. Kështu që, gjykoj që për

pikën /A/, me nëndarësen /a/, “Aftësinë për të identifikuar natyrën”, duhet të vlerësohet shumë e lartë, me 25 pikë.

Po kështu, gjykoj që për “Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmëria e vendimit”, që është vlerësuar me “mesatare”, 9, duhet të vlerësohet me “shumë të lartë”, me 12 pikë. Kjo, duke parë raportin, konkluzioni i relacionit është: Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi nuk evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese-arsyetuese, tek nëndarja e pretendimet e palëve apo tek analiza ligjore, ku konstatohet se disa pjesë të tij përsëriten fakte, dispozita ligjore si dhe qëndrime të Gjykatës së Lartë. Paraqitja jo gjithmonë e përmbledhur e pretendimeve të palëve, apo tendenca për të pasqyruar një pjesë të konsiderueshme të qëndrimit të Gjykatës së Lartë, duke sjellë edhe përsëritje të herë pas hershme, nuk e bën të qartë vendimin për një person të zakonshëm. Në mungesën e koncizitetit ndikon edhe mospërdorimi i saktë i rregullave gramatikore në ndërtimin e fjalive dhe përsëritja e mendimit në disa pjesë.

Referuar sa më sipër, dhe kundërshtimit që ka bërë edhe vetë gjyqtarja, ajo e ka vlerësuar si shumë të lartë aftësinë për të interpretuar dhe për të qenë koncize në vendim, gjykoj që këto nuk janë arsye për të cilën të penalizohet. Ne kemi vlerësuar gjyqtarë me 400 pikë, që kanë pas vendime me nga 100 faqe dhe s’i kemi quajtur që s’janë koncize, por i kemi quajtur të arsyetuara; dhe përsëritja e mendimit në disa raste kur ajo do të theksojë gjëra që gjykon, nuk e konsideroj si të metë në arsytimin e vendimit. Kështu që, pjesa më e rëndësishme që është evidentuar në këtë konkluzion është që gjyqtarja i kushton rëndësi kuptueshmërisë së vendimit në drejtim të lexuesit dhe të palëve në proces, dhe njerëzve të tjerë që s’kanë njohuri juridike, është pjesa më e rëndësishme e cila ia vlen të nënvizohet dhe të vlerësohet maksimalisht si shumë e lartë, me 15 pikë.

Njëkohësisht, “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është vlerësuar me 8 pikë. Gjykoj që duhet të jetë mbi mesatare, me 10 pikë, sepse nga vetë relatorja thuhet: Gjyqtarja strukturon qartë mendimin dhe argumentin logjik në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes.

Edhe për këtë gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, kështu që gjykoj që duhet të vlerësohet edhe kjo “shumë e lartë”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, Irena!

Irena Plaku: Atëherë, lidhur me kundërshtimet e paraqitura nga anëtarja znj. Luli, atëherë sqaroj njëherë në radhë të parë që ai është vetëvlerësimi i gjyqtares dhe të gjithë vetëvlerësimet e gjyqtarëve përgjithësisht kanë qenë të gjitha, për të gjitha nivelet "Shkëlqyeshëm", por ka pasur edhe gjyqtarë (thjesht për t'i evidentuar) të cilët e kanë vlerësuar aftësinë e tyre "mbi mesatare", të paktën sidomos tek "Aftësia organizative", por pasur parasysh analizën e të dhënave, ne përsëri kemi shkuar në një nivel "Shkëlqyeshëm", pasi ka rezultuar...

Të lutem, po e mbaroj unë njëherë dhe do i marrë me radhë të gjitha.

...në kuptimin që unë orientimin e kam, sepse unë për sa kohë që i kam përshkruar të gjithë vetëvlerësimin e gjyqtares në projektraport, e kam përshkruar atë. Po pra po, e kam përshkruar atë. Kështu që, nuk kam hequr asnjë gjë nga ato që duhet të paraqiten apo të cilat unë e kam vlerësuar të nevojshme që duhen përshkruar. Pra nuk janë kundërshtime por është vetëvlerësimi i gjyqtares. Gjyqtarja nuk ka paraqitur kundërshtime, duke qenë dakord lidhur me këto vlerësime.

Gjithashtu, vë në dukje ndër të tjera që në projektraportin e parë të vlerësimit të gjyqtares, përsëri gjyqtarja është vlerësuar në nivelin, pavarësisht se ka qenë "Shkëlqyeshëm", në këtë rast është ulur vetëm në një tregues pikëzimi më shumë nga raporti i parë, dhe nga raporti i parë të gjithë ne e kemi vlerësuar në atë nivel, për të gjithë këto treguesit që ju kundërshtuat sot.

Ju në fakt lexuat vetëm konkluzionet në të cilat unë kam arritur. Për të arritur në ato konkluzione është bërë një analizë, të paktën për treguesin e parë, nga faqja 6, është bërë një analizë e detajuar edhe e vendimeve gjyqësore, deri në faqen 13.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Të lutem, ta mbaroj unë. Nuk të ndërpreva.

Unë nuk të ndërpreva, apo jo.

Naureda Llagami: Të vazhdojë Irena, pastaj...

Irena Plaku: Të lutem, unë thjesht po të relatoj atë që mendoj unë të arsyeshme.

Atëherë, nga faqja 6 deri në 13, unë kam përshkruar në mënyrë të detajuar çfarë kam konstatuar në secilin vendim burim vlerësimi. Ajo që i janë ulur pikët gjyqtares lidhur me këto tregues, në të cilën është vlerësuar “mbi mesatare”, i është ulur vetëm për sa i përket nëntreguesve në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes. Konkretisht po lexoj përmbajtjen e faqes 6:

Referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes, konstatohet se në vendimet burim vlerësimi, përgjithësisht gjyqtarja nuk i kushton rëndësi përshkrimit të fakteve të çështjes si atyre me natyrë procedurale ashtu edhe ato që lidhen me rrethanat të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin e çështjes. Konstatohet se përgjithësisht gjyqtarja e fillon arsyetimin e vendimit me parashtrimin e pretendimeve të palëve lidhur me faktet dhe arsyetimin ligjor.

Pra gjyqtarja parashtron të gjithë pretendimet e palëve në projektvendim dhe më pas fillon arsyetimin duke kaluar direkt tek analiza ligjore.

Referuar metodologjisë së vlerësimit, një nga elementët që duhet të ketë vendimi është përshkrimi i fakteve siç kanë rezultuar nga hetimi gjyqësor. Padia është pretendimi i palës paditëse, ndërsa prapësimet e palës së paditur janë përshkruar patjetër. Një ndër elementët thotë që duhen përshkruar në mënyrë të përmbledhur, që një vendim t'i ketë të gjithë ato elementë të nevojshëm, edhe pretendimet e palëve. Ndërsa në këto disa vendime, siç e thamë, mungon tërësisht përshkrimi i rrethanave të faktit.

E ke këtu, tek faqja 9. Tek faqja 6. Mund ta lexosh projektraportin.

(Zonj Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Analiza ligjore, pjesa e vendimit, ka disa pjesë vendimi. Vendimi ka përshkrimin e rrethanave të cilët duhet të bëhen sipas atyre që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe jo atë siç e referojnë palët, duhet të bëjë një përshkrim të vetën sepse nga përshkrimi i fakteve kuptohet qartë dhe vendimmarrja e gjykatës. Mospërshkrimi saktë i fakteve ose i qartë, apo mospërshkrimi i fakteve, tregon mangësi në arsyetim. Analiza më pas është analiza që i bën ligjit në raport me faktet e çështjes. Këto duhet të jenë përshkruar në pjesën e parë të vendimit. Nuk i është ulur pikë pse ka shkruar pretendimet e palëve. Në rast se do të kishte shkruar edhe përshkrimin e fakteve siç ka rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe jo pretendimet e palëve, atëherë po, do ta vlerësoja, por nuk ka bërë asnjë

përshkrim të fakteve të çështjeve. Gjithsesi unë kështu e kam vlerësuar dhe jam referuar vendime të saj burim vlerësimi. Dhe për këtë tregues, me të njëjtat shkaqe është vlerësuar edhe tek projektraporti i parë 2013-2016 në të njëjtin pikëzim.

Kalojmë tek treguesi tjetër për të cilin ju kërkuat një vlerësim maksimal, është tek “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”. Në projektraport është analizuar në mënyrë të detajuar mangësi të cilat janë analizuar dhe kanë rezultuar nga vendimet burim vlerësimi ku siç kam theksuar ka pasur edhe mospërdorim të rregullave gramatikore, drejtshkrimit të saktë të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.

Në fakt të shkruash mirë është një nga elementët thelbësorë që duhet të ketë një vendim. Është një dokument zyrtar dhe i drejtohet të gjithë njerëzve. Vendimi gjyqësor është në emër të republikës dhe nuk duhet të ketë mangësi të tilla në lidhje me drejtshkrimin.

Gjithashtu edhe sa i përket koncizitetit është parë, siç e relatova, unë në fakt këtë pjesën e lexova në mënyrë të detajuar. Në raport me vlerësimin e parë këtu është ulur edhe një nivel tjetër për shkak se ka pasur edhe përsëritje. Pra përshkruan pretendimet e palëve. Dhe vendimet unifikuese të cilët pala paditëse e ka relatuar, duke pasqyruar në pjesën e vendimeve dhe më pas përshkruan përsëri të njëjtat gjëra tek arsyetimi ligjor, duke shkruar për shembull (po marrë një shembull), vendimi unifikues lidhur me shkakun ligjor apo dëmin, dy faqe e gjysmë përmbajtjen e vendimit, vendimit unifikues. Më pas ky vendim, duke analizuar përsëritet përsëri (përmbajtja), e cila s’është e nevojshme që vendimi të jetë kaq... Mira pra, ky është vlerësimi im. Ky është vlerësimi im.

Fatmira Luli: Ajo s’ka bërë ankesë, sepse procesin s’do ta pengojë. Ky ndryshim ka të bëjë vetëm me dinjitetin e saj, nuk ka të bëjë me vlerësimin, se ajo në “pull” (pozicion) është vetëm. Por gjykoj që ajo nuk e meriton të marri këtë vlerësim.

Irena Plaku: Atëherë, unë nuk diskutoj integritetin e gjyqtares, as nuk e kam diskutuar fare dhe po të kishte mungesë integriteti do të ishte vlerësuar ndryshe në fakt. Vlerësim të lartë kam edhe për gjyqtaren, por i jam referuar burimeve të vlerësimit. Ne kur vlerësojmë një gjyqtar nuk nisemi nga njohjet personale apo nga ato që ne dimë për një gjyqtar, por i referohemi pikërisht vendimeve burim vlerësimi dhe nga vendimet

gjqësore burim vlerësimi më kanë rezultuar këto fakte të cilat janë përshkruar. Ju pëlqejnë, s'ju pëlqejnë, këto janë. Vendimet gjyqësore mund edhe t'i lexoni dhe t'i shikoni. Nuk e ka ndaluar ndonjë. Por i gjithë përshkrimi që është bërë në projektraport, nuk është bërë në lidhje me njohjet, por është bërë vetëm në bazë të burimeve të vlerësimit të sqaruara dhe përshkruara në projektraport. Janë të përshkruara. Nuk janë subjektive, janë të përshkruara në projektraport në mënyrë të detajuar.

Naureda Llagami: Ok!

Në fakt, duke qenë se jemi tek procesi i rishikimit të skemës së vlerësimit dhe ndoshta ne që jemi pak më shumë në kohë këtu na lind e drejta që të vlerësojmë dhe pse jo të bëjmë edhe reflektime mbi atë. Sot ne po gjykojmë në fakt Irena një kolegen tënde, por është edhe një kolege e cila ka 20 vjet në detyrë, mbi 20 vjet dhe që pa diskutim që Gjykata e Tiranës është një gjykatë në të cilën kompleksiteti i çështjeve nuk mund të krahasohet me asnjë gjykatë tjetër në Republikën e Shqipërisë. Pra ju vetë e përmendët që kishin çështje tregtare, kishin çështje që ndoshta gjykata të tjera që ne mund t'i kemi nxjerrë kolegët tanë edhe më mirë, s'mund ta kishin atë kompleksitet që ka Gjykata e Tiranës; aq më shumë që gjyqtarja ka punuar edhe në seksion tregtar, ku po t'i referohem në pjesën e kompleksitetit dhe standardet që përdorin vendet bashkëkohore, seksioni tregtar është seksioni më kompleks dhe që çështjet marrin më shumë pikë.

Ne në fakt na mungon rregullorja e ndarjes së çështjeve në komplekse. Edhe pse ligji e ka parashikuar, ne akoma nuk e kemi, të paktën nga ana e komisionit tuaj nuk është bërë një propozim kush konsiderohet. Ne akoma jemi tek ndarja e çështjeve me palë dhe ndarja e çështjeve pa palë. Jemi akoma tek kërkesa e çështjeve. Ndërkohë që, kompleksiteti i çështjeve (ju që jeni edhe gjyqtarë por edhe unë që ndoshta kam qenë përdoruese e gjykatave) ka të bëjë me pjesën e natyrës, ka të bëjë me pjesën e llojit të konfliktit, ka të bëjë me identifikimin e shkaqeve që ka një gjyqtar, shtuar edhe atë që tha edhe Albani, që të paktën për 2022, kolegja ka qenë në pjesën e një presioni që ka qenë vetingu. Të gjitha këto janë elementë që nuk ka qenë në një situatë, pra nuk mund ta krahasojmë dot, personalisht kur vij dhe shqyrtoj kolegët e Gjykatës së Tiranës, jemi në këtë lloj sfide sepse Gjykata e Tiranës është gjykata më komplekse që shqyrton çështjet

më të vështira dhe më komplekse. Të paktën ky është një fakt i njohur nga të gjithë ne, aq më shumë ju që e dini edhe më mirë se vini nga ato gjykata.

Në këtë prespektivë unë mendoj që ndoshta edhe tek pjesa e rishikimit që do i bëni metodologjisë (nga grupi i punës që po punon), duhet patjetër të bëhet ndarja e atyre gjyqtarëve që gjykojnë çështje komplekse, që gjykojnë çështje me shumë kërkime, që gjykojnë çështje të cilat kanë palë dhe s'mund të krahasohet pa diskutim një gjyqtare e Tiranës që gjykon këto çështje, me një gjyqtar të një rrethi tjetër që ndoshta gjykon vetëm çështje familjare, ndoshta gjykon vetëm çështje të thjeshta (kërkesa) dhe merr një vlerësim "Shkëlqyeshëm".

Në këtë pjesë në fakt unë kam një lloj rezerve, tek pjesa e metodologjisë në identifikimin e çështjeve sepse unë besoj që gjithsecili prej nesh, çështjet që janë me natyrë më të thjeshta i ka më të përdorshme, i kupton më mirë, ndërkohë që të identifikosh dhe të zgjidhësh natyrat e çështjeve komplekse, kjo pastaj është një sfidë më vete për gjyqtarët.

Sot unë vij me statistika, ku brezi i ri në fakt jo vetëm që s'po gjykon çështjet, por brezi i ri po aplikon kthimin e akteve se refuzojnë të gjykojnë qoftë edhe çështje komplekse.

Prandaj, ajo që do doja, dhe gjej rastin duke qenë se keni filluar rishikimin, duhet ta shihni edhe në këtë perspektivë. Metodologjia është vërtetë e njëjtë për të gjithë, por individët nuk janë të njëjtë dhe eksperiencia e tyre nuk është e njëjtë për të gjithë dhe neve nuk mund ta vëmë atë metrin në mënyrë kaq strikt në vlerësimin e gjyqtarëve, duke marrë parasysh edhe pjesën e ambientin ku punojnë, e stresit ku punojnë, por edhe pjesën e kompleksitetit, që për mua është shumë e rëndësishme kompleksiteti i çështjeve që ka civilja Tiranë me civilen qoftë edhe në rrethet e tjera sa të largohemi nga Tirana.

Irena Plaku: Ndër të tjera, unë e di vështirësinë e Gjykatës së Tiranës, edhe tek çështjet civile, se kam punuar vetë aty, dhe e di edhe tek tregtarja, edhe tek civilja dhe tek familjarja. Tek të tre seksionet që kam punuar, e di çfarë do të thotë vështirësia. Për këtë arsye, pasur parasysh të gjitha vështirësitë, pavarësisht se numri i çështjeve janë shqyrtuar tej afatit ligjor, që ishte shumë i lartë, për të cilën neve në raportin e gjyqtarëve të rretheve nuk i kemi ngritur tre nivele, në këtë rast është vlerësuar e gjithë kjo ngarkesë

e gjyqtares, e gjithë kjo ngarkesë si në numër çështjes por edhe llojin e çështjeve, arsye të cilat e thashë unë, vetingu, dhe për këto arsye tek afati ligjor është rritur me tre nivele, jo me një. Por pasur parasysh se edhe data e caktimit të seancave nuk duket që kishte marrë direkt masat, afatet ligjore nuk shkojnë, duke pasur 80 e ca %, të shkojë në nivelin maksimal (mendoj unë), sepse atëherë do humbte koncepti i afateve ligjore. Ndërsa, tek standardi... Të lutem. Për sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve, llojit të çështjeve, të cilët është shumë e madhe absolutisht, është marrë në vlerësim; për këtë arsye është vlerësuar "Shkëlqyeshëm". Është vlerësuar "Shkëlqyeshëm" për atë kriter, "Aftësitë organizative". Ngarkesa merret pikërisht tek aftësitë organizative. Por ngarkesa nuk mund të justifikojë asnjëherë cilësinë e vendimit.

Kështu thotë metodologjia e vlerësimit. Unë nisem tek metodologjia e vlerësimit. Vlerësimi është bërë referuar metodologjisë së vlerësimit.

Naureda Llagami: Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Atëherë, doja të thoja edhe unë mendimin tim në lidhje me këtë situatën dhe bashkë me mendimin të bëja edhe unë një propozim në lidhje me propozimet e bëra nga relatorja për vlerësimin e znj. {...}.

Fillimisht e marrë pikënisjen nga fakti që ajo është gjyqtare me përvojë dhe unë këtë nuk e shmang, siç nuk e kam shmangur ndonjëherë përvojën si pjesë të punës së gjyqtares, si pjesë të ngarkesës, të përgjegjësisë, durimit, sfidave më të madha që ka kaluar në raport me gjyqtarët e rinj dhe kjo pjesë është pjesë që na motivon për ta parë ndoshta edhe më me hollësi projektraportin e paraqitur dhe të diskutuar ditën e sotme.

Unë këtë gjyqtare nuk e njoh personalisht, nuk e njoh, s'kam pasur mundësi ta njoh personalisht. Ajo ka punuar gjithë jetën e vet gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë, aktualisht Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë. Unë kam punuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, as nëpër seminare, as në trajnime nuk e kam pasur mundësi ta shoh. Kontakti, situata e parë lidhet me këtë projektraportin e paraqitur ditën e sotme. Di që është një gjyqtare e vjetër. Është më e vjetër se sa unë në detyrë dhe unë personalisht i vlerësoj gjyqtarët që janë të vjetër në detyrë sepse kanë dhënë kontribute më të mëdha se sa ato që janë të rinj.

Tani në lidhje me komponentët dhe treguesit. Dakordësohem me një pjesë të madhe të propozimeve të paraqitura nga relatorja. Kam vetëm disa propozime të miat alternative. E para lidhet me “Njohuritë ligjore”. Dakordësohem me atë çfarë tha zonja Luli. Në këtë tregues janë tre komponentë: “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave”. Në lidhje me ligjin e zbatueshëm, besoj se nuk kemi probleme, është maksimale. Në lidhje për të identifikuar natyrën e çështjes dhe konfliktin e normave ka ca rezerva në raport. Janë rezerva të pasqyruara në raport. Mbi bazën e këtyre rezervave është bërë edhe vlerësimi që është 20 pikë, jo 25.

E para lidhet me aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes dhe kjo lidhet me pasqyrimin e rrethanave të faktit. Unë siç e kam lexuar, kam lexuar projektraportin. Më rezulton që rrethanat e faktit gjithsesi nuk janë ceduar nga përshkrimi që bën gjyqtarja në pjesën e vendimmarrjes së saj. Është e vërtetë që në projektraport pasqyrohet fakti që rrethanat e faktit nuk janë përshkruar si një pjesë e strukturës së vendimit sepse ajo një herë i referohet paraqitjes, parashtrimit të palëve që bëjnë në proces gjyqësor dhe një herë tjetër po në këtë raport thuhet që “pasqyrimi i rrethanave të faktit integrohen në pjesën e analizës së vendimit”, pra është e integruar në pjesën e analizës së vendimit gjyqësor dhe atje e kupton lexuesi që gjatë analizës pasqyrohen edhe rrethanat e faktit. Kështu që në këtë pikë unë kuptoj dhe vlerësoj që referuar të paktën nenit 310 të K.Pr.Civile, ku gjyqtari e ka për detyrim të pasqyrojë rrethanat e faktit, ajo i pasqyron në vendimet e dhëna prej saj, i pasqyron si tregues më vete, domethënë si një nënndarje më vete në vendim apo i pasqyron tek pjesa e analizës, kjo është një situatë që lidhet me individualitetin e të menduarit, të shkruarit dhe të pasqyruarit të vendimit të gjykatës dhe të gjyqtarës. Por nuk ka ceduar në vlerësimin tim në këtë tregues.

Në lidhje me po treguesin e “njohurive ligjore”, por tani me komponentin e konfliktit të normave, është thënë aty në projektraport që nuk identifikohet apo... është një fjali.

(Zonja Plaku flet pa ndezur mikrofonin.)

Qartë pra. Ok, mirë!

Ok, po e lë këtë pjesën.

Iku, mbaroi!

Domethënë, doja të thoja vetëm kaq që, të paktën, një gjyqtare si gjyqtare që gjykon në fushën civile, nuk mund ta shmangi dot (ju e dini më mirë) konfliktin e normave. Pse nuk e shmang dot? Ndoshta në penale është pak më e thjeshtë situata (ta them këtë pjesën). Ndërsa në civile është e pashmangshme për shkak se ka koneksitet çështjesh (është paditësi, kundërpadia, ndërhyrësi kryesor, faktet ose i njëjti fakt mund të pretendohet në disa shkaqe të ndryshme ligjore, nga ndonjë ligj ose dispozitë e Kodit Civil në një ligj tjetër të posaçëm nga ana tjetër), kështu që gjyqtari në praktikën e punës së tij e ka të pamundur ta shmangi trajtimin e konfliktit të normave në një proces gjyqësor dhe vendimmarrës. Në këtë rast nuk do ndalem më tepër. Është e pasqyruar tek pjesa e “Aftësisë për të interpretuar ligjin” janë dhënë edhe situatat se si i ka trajtuar ajo ligjin për pronësinë (tek dekreti i pronësisë), ligji i vitit 81 i Kodit civil dhe i 94 që lidhet me regjimin e bashkëpronarëve dhe çështjet që lidhen me trashëgiminë. Pra janë ligje të ndryshme, ka konflikt normash dhe... E qartë. Vetëm për shembull.

(Zonja Plaku flet pa ndezur mikrofonin.)

Pra është pjesë. “Tempus regit actum”, por kanë regjime të ndryshme rregullimesh. Tjetër gjë e mendoni ju por tjetër gjë e mendoj edhe unë.

Vazhdojmë tek pjesa tjetër që lidhet me “Arsyetimin ligjor”. Tek treguesi i “Arsyetimit ligjor” është komponenti “Qartësia, konciziteti...

Ju lutem bëni durim dhe unë do t’i them të gjitha gjërat. Mund ta kem gabim. Ma thoni në fund.

“Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”. Në këtë pikë gjyqtarja është vlerësuar në nivelin mesatar me 9 pikë dhe duke parë projektraportin konstatova që ka probleme në lidhje me komponentin “qartësi” dhe “koncizitet”, ndërsa për kuptueshmërinë e vendimit nuk ka probleme.

Tani, qartësia dhe konciziteti lidhen me disa elementë që vihen në diskutim në këtë projektraport dhe cilat janë? Janë gramatika e përdorur në vendimmarrje ku mungojnë “ç”-të, ku mungojnë “ë”-të.

Në një rast “shpenzimet gjyqësore, pranimi pjesërisht i padisë” dhe në shpenzimet gjyqësore gjyqtarja, meqenëse është pranuar pjesërisht padia, nuk ka shpjeguar raportin e shpenzimeve që duhet t’i ngarkohet palës fituese pjesërisht dhe palës humbëse pjesërisht.

Në lidhje me koncizitetin, i referohet situatës kur gjyqtarja, po themi, në një pjesë të vendimmarrjes integronte, përveç shpjegimeve të palëve, integronte edhe vendimet e Gjykatës së Lartë që mund të ishin të gjata (1 ose 2 faqe në vendimmarrje) si dhe fjalitë e saj që ishin të përsëritura dhe të gjata.

Këto besoj se janë në mënyrë të përmbledhur ato çfarë unë evidentova në lidhje me këtë tregues.

Atëherë, në këtë pikë unë mendoj që përtej propozimit që ka bërë relatorja, mendoj që ky propozim nuk është proporcional në raport me faktet e evidentuara. Kështu që, unë propozoj jo maksimumin, por propozoj mbi nivelin mesatar, pra nga 9 t'i shtohen edhe plus 3, pra jo plus 6 por plus 3 në “Arsyetimin ligjor”. E dyta. Tek “Arsyetimi ligjor” është “Qartësia, koncizitetin dhe kuptueshmëria”. Domethënë këtu, nga 9 që ka propozuar, unë nuk propozoj maksimumin por propozoj 12. Ka elemente por thashë nuk është proporcionale propozimi. Ka elemente që janë të vërteta që ajo duhet t'i përmirësojë dhe për këtë nuk jam tek maksimumi i pikëve por ka elemente që për mua janë të kaluara në këtë vlerësim. Pra nga 9 të bëhet 12.

Së fundmi është treguesi që lidhet me “Gatishmërinë e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera” dhe është nëntreguesi “Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, është propozuar 4 pikë. Arsyeja: Gjyqtarja në vitin 2022 ka ndjekur gjithsej katër ditë trajnimesh në Shkollën e Magjistraturës. Realisht Shkolla e Magjistraturës, sipas raportit të paraqitur, në një trajnim ku gjyqtarja e kishte planifikuar për të shkuar në dy ditë, Shkolla e Magjistraturës ka marrë një vendim (bordi i saj), por nuk gjendet se kur është marrë ky vendim i bordit, i ka ndërruar planin dhe nga dy ditë (është vetëm rrethanë fakti kjo) gjyqtares i ka shkuar një ditë. Pra në planifikimin njëvjeçar të viteve akademike që fillon tani për shtatorin, ajo e ka bërë planifikimin e saj për 5 ditë. Ndërkohë, në një moment të paevidentuar në kohë, shkolla i thotë, na vjen keq tani, por nga dy ditë ne po ta bëjmë një ditë (dhe katër ditë). Gjyqtarja jep shpjegimin dhe thotë, kjo situatë ka ndodhur në dhjetor të vitit 2022. Pra është situatë e dhjetorit, ku ajo as mund të rikuperonte janarin, shkurtin e marsin për atë kohë. Kështu që, unë vlerësoj që këto janë rrethana të cilat nuk varen nga vullneti i gjyqtares por varen nga mënyra e organizimit të Bordit të Shkollës së Magjistraturës, që në planifikimin e saj, nga 2 ditë seminare për

një vit, e ka bërë 1 ditë. Kështu që, në këtë situatë, unë mendoj që këto rrethana nuk mund t'i ngarkohen gjyqtares pse bordi i shkollës ka marrë atë vendim dhe nuk del as nga bordi i shkollës se kur e ka marrë këtë vendim që t'ia njoftojë edhe gjyqtares. (bordi i pedagogëve).

(Zonja Muçi flet pa ndezur mikrofonin.)

Janë në dokument. Unë nga raporti i mori.

Unë nuk hetova që ta merrja vetë dokumentin, por janë nga raporti. Domethënë nuk janë fjalë, janë ato çfarë janë thënë në raport.

Kështu që, ndodhur në këto kushte unë propozoj, sepse në këtë rast janë rrethana të cilat nuk janë varur nga vullneti, nuk i është shmangur magjistratja në planifikimin e vet. Alternativa është 4 dhe 20. Kështu që në këtë pikë unë propozoj që të shkojë 20. Këto janë propozimet e mia.

Faleminderit!

Ridvan Hado: Faleminderit!

Zonja Enkela {...} ({...}) është nga gjyqtaret më të vjetra dhe më të mira të Gjykatës së Tiranës, me gjatësi në punë afër 30-vjeçare.

Pa i hyrë analizës së elementëve apo kriterëve dhe nënkritereve jam i mendimit që meriton vlerësimin më të lartë të mundshëm. Më fal, pa i hyrë analizës.

Nga ana tjetër, ky Këshill ka vendosur si standard që pa kundërshtuar vlerësimin nga ana e subjektit, pra nga gjyqtarja, nuk kemi rritur pikë asnjëherë. Të paktën dua të jem korrekt me veten time. Pavarësisht se mbaj qëndrimin, pa kundërshtime nga gjyqtari apo gjyqtarja, në asnjë rast ne nuk kemi shtuar pikë. Për të qenë në koherencë me veten time, me parimet e mia, dhe në të gjithë rastet e tjera, përmendim zotin Çomo, por ke dhe dhjetëra raste të tjera pa përmendur emra, që ne nëse bie dakord gjyqtari për vlerësimin, pavarësisht se qysh e tek, ne kemi vendosur si standard si Këshill; pavarësisht se ruaj mendimin që zonja {...} meriton pikët maksimale, jam kundra me propozimet. Faleminderit!

Naureda Llagami: Për trajnimet. Po, Irena!

Po!

(Merr fjalën përpara z. Toro)

Alban Toro: Atëherë, zakonisht kjo është një procedurë administrative dhe në këtë aspekt rregullohet edhe nga Kodi i Procedurës Administrative dhe normalisht, në rastin konkret kemi të bëjmë me një cenim të interesit të gjyqtarit nëse projekt drafti do të miratohet i tillë, dhe në këtë kontekst gjyqtari duhet të bënte një oponencë personale për këtë pjesë, të paktën do i kishte hije për shkak edhe të eksperiencës së gjatë që ka. Unë jam nga ata komponentë të KLGJ-së që gjithmonë kam respektuar dhe jam përlur përpara eksperiencës, madje kam kërkuar, në rastet e ankimeve të subjekteve të tilla me eksperiencë të gjatë, kam kërkuar edhe të retushoj projektin, atë pjesë të cilën eksperiencia e nderonte. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh që neni 128 i K.Pr.Administrative rregullon në mënyrë të veçantë mënyrën se si ankimohet qoftë edhe një projekt draft që është në rastin konkret projektvlerësimi personal etiko-profesional i gjyqtarit, do të duhet që kjo e fundit minimalisht të kishte ezauruar pjesën e vet të ankimit. Në kushtet kur mungon ky fakt, unë do dëshiroja, për të arritur edhe vetë në një konkluzion, do dëshiroja ta thërrisnim këtu dhe ta dëgjonim në lidhje me atë që ajo ka për pjesën e vlerësimit etiko-profesional. Ndoshta nga ky ballafaqim se si ajo e mendon këtë raport, çfarë problemesh ka konstatuar, ndoshta ajo mendon që është e drejtë. Pastaj i gjithë ky diskutimi ynë nuk e di, nëse i zoti i punës thotë që është i drejtë, ne të themi që jo, duhet të japim më tepër, nuk më përkon.

Një minutë Fatmira!

Kështu që unë e kam të nevojshme që të kem edhe ballafaqimin e saj.

Kemi bërë një rast të tillë. Madje gjyqtari s'ka ditur as të artikulohet sepse ka thënë që unë jam filani dhe kërkoj pikë, pa argumentuar se për çfarë pikësh bëhej fjalë dhe ku i kërkonte këto ngritje pikësh. Dhe ky keqartikulim më bëri që të mos ndryshoj projektin e relatorit të asaj kohe.

Kështu që unë do ta kisha të nevojshme të konsultohesha dhe me ballafaqimin paraprak që do bënim në një seancë tjetër të afërt, shumë të afërt, ku të kisha mundësi të njihesha edhe me opinionin personal të gjyqtarit në lidhje me raportin etiko-profesional. Nuk besojmë se do bëjmë ndonjë shmangie nga procedura. Procedura e parashikon, sidomos K.Pr.Administrative, parashikon ndërhyrje të tilla dhe nuk ka asgjë të keqe që

70

ne të dëgjojmë këtu opinionin e gjyqtarit nëse ka probleme të konstatuara me projekt draftin e raportit, nëse s'ka, pastaj unë do të jem i limituar në vullnetin tim për ta votuar ndonjë ndryshim të mundshëm sepse kam mbajtur një standard të tillë. Jo pa qëllim përmenda z. Çomo, për vitin 2013-2016, pavarësisht se s'kam qenë në opinionin që të ishte ai vlerësim, mungesa e investimit nga ana e z. Çomo me një ankim të veçantë, më bëri të tërhiqesha dhe të pranoja vlerësimin e relatorit. Kështu që, duke qenë që kam pasur edhe një standard të tillë, do të ishte shumë me vlerë edhe për vetë Këshillin nëse do ta thërrasim, ta dëgjojmë në lidhje me opinionin e vet personal.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi përpara procedurës.

Lidhur me shqetësimin që z. Hado ngriti, nuk është e vërtetë, sepse ne kemi ngritur. Ju kujtoj në fund (pa dashur të përmend emra), kemi ngritur bile edhe vetë relatori ka ngritur kur ka bërë propozimin edhe pse s'kishte kundërshtime. Këtë ta sjell me statistika se e kemi. Kështu që tek kjo pjesë nuk ka gjë.

Tek pjesa, e detyrojmë ne palën që të vijë, kur pala e ka thënë të qartë që nuk dua të vij dhe është në diskrecionin e organit, edhe këtu më duket që neve nuk jemi në këtë pjesë.

Kështu që ne vazhdojmë procedurën siç e kemi nisur. Nëse keni propozime konkrete, Ok. Nëse jo, kalojmë në votim me këto propozime që kemi.

Alban Toro: Jo, propozimi im është që unë, për të qenë në gjendje për të votuar në lidhje me propozimin që bën relatori, kam nevojë të dëgjojë palën. Tani, çfarë lidhje ka këtu pala; s'ka pala. Unë bëra një kërkesë procedurale.

Atëherë, unë do pranoj relatoren dhe i them mirupafshim palës.

Unë jam brenda shkaqeve të ankimit. Edhe unë kështu funksionoj.

Ore po të dojë le të vijë, po të dojë mos të vijë. Unë me zor nuk marrë njeri këtu. As nuk e detyroj të vijë me përdhunë. Në qoftë se ajo nuk është e aftë të mbrojë veten këtu dhe e konsideron të lërë në fuqi institutin e heshtjes, unë atë institut e aprovoj në një formë tjetër. Nëse do të kemi një gatishmëri për të ardhur, për t'u përballur me problemet që ka nxjerrë ai raport, hajde bujrum, të flasim, të diskutojmë. Një gjyqtar nuk duhet të ketë frikë nga përballja.

Nuk e di. Unë kam nevojë ta dëgjojë. Se mund të më thotë prapë si ai gjyqtari tjetër që unë jam filani, kërkoj që të më ngrihen pikët. Atëherë pastaj do bashkohem me relatoren. Çfarë të them unë?!

Irena Plaku: Atëherë, për procedurë edhe unë.

Gjyqtarja është njoftuar rregullisht si për projektraportin ashtu edhe për seancën dhe nuk ka dashur të vijë (se nuk po them që nuk ka pranuar), ka zgjedhur me vullnetin e saj të lirë të mos paraqesi kundërshtime, të vazhdojë me projektraportin.

Edhe atë pretendimin që duke qenë se është e vetme në pozicion, - pavarësisht se kanë qenë të vetëm në pozicion, kur kanë vlerësuar që nuk kanë pasur një vlerësim të drejtë, kanë paraqitur kundërshtime, sepse nuk e pengon kjo procedurë apo paraqitja e kundërshtimeve, emërimin e saj, absolutisht jo.

Gjithashtu, në lidhje me pikëzimin, thashë, afërsisht të njëjtat pikë janë bërë edhe tek vlerësimi i mëparshëm i gjyqtares, përveç një ndryshimi tek njëri nga treguesit, që i është ulur...

Naureda Llagami: Irena, fokusohu vetëm tek pjesa procedurale. Çfarë do bëjmë proceduralisht për kërkesën që thotë Albani?

Irena Plaku: Proceduralisht unë them që nuk kemi mundësi që neve proceduralisht ta shtyjmë seancën, sepse projektraporti, vendimet burim vlerësimi shikohen nga ana e të gjithë anëtarëve dhe vlerësimi bëhet mbi akte, jo mbi atë çfarë thotë gjyqtari në seancë apo mbi atë se çfarë ka bërë vetëvlerësim gjyqtari, bëhet vetëm mbi aktet. Dhe unë mendoj që nuk duhet.

Naureda Llagami: Mirë, tani e hedhim në votim, në qoftë se juve mendoni kështu, e hedhim në votim kërkesën e Albanit dhe ta thërrasim apo jo, pasi e kemi ezauruar këtë proces nga ana e relatores?

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Edhe unë dakord.

T'ia përsërisim edhe një herë çështjen.

Atëherë, e shtyjme seancën.

E shtyjme edhe një herë seancën për t'i komunikuar dhe për t'i dhënë mundësi magjistrates për t'u paraqitur në seancën tjetër.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.06.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:32 dhe mbaroi në orën 13:56.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent online në një pjesë të mbledhjes).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e fundit e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme për shkak të një kërkesë të ardhur nga kjo gjykatë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Kurushi.

Fjalën e ka z. Kurushi mbi relatimin e aktit për caktimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër që është në nevojë.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Relacioni i radhës i paraqitur nga ana e Komisionit ka për objekt caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Deri më datë 21.06.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, kërkesë e parashtruar nga Zëvendëskryetarja e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme. Çështja është me natyrë penale. Objekti i akuzës “Nenet 284/1, 28/4, 283/a/1, 287/1/b-25, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal”.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit bëhet i pamundur për t’u aplikuar në rastin konkret.

Ndodhur në këto kushte Komisioni propozon zbatimin e mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Propozimet mbështeten në paragrafin X/2 të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë”. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, referuar referencave të mësipërme ligjore propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 (një) i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Referuar paragrafit VIII të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së

Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. {...}, si dhe gjyqtarët që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}.

Njëkohësisht në listën bashkëngjitur janë propozuar të mos përfshihen në short edhe gjyqtarët që kanë pengesa ligjore të ndryshme nga ato që i referohen çështjes konkrete, siç është zonja {...} për të cilën ne kemi mbajtur një qëndrim në mbledhjen e mëparshme.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Të vijohet me hedhjen e shortit nga administrata.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen penale nr. 31, datë 02.05.2024 gjyqtare e përzgjedhur është Edlira Petri.

Naureda Llagami: Atëherë me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

Punë të mbarë të gjithëve.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor